




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.72/24
Datë: 19.08.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023 Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkatës. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e datës 19.08.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqendrim i ndërmarrjeve lidhur me marrjen e kontrollit nga Nova Ljubljanska Banka d.d., mbi kompaninë e synuar Addiko Bank AG.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 21.07.2024, me Nr. Prot. 389/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit nga NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d., mbi kompaninë e synuar Addiko Bank AG

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 16.07.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 17.07.2024
3. Transaksioni bazohet në Ofertë Publike Vullnetare të datës 7 qershor 2024 që synon të blejë të gjitha aksionet e zakonshme të emetuara dhe të papaguara pa vlerë nominale të Addiko Bank AG (ISIN AT000ADDIKO0).

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Transaksioni bazohet në Ofertë Publike Vullnetare të datës 7 qershor 2024 që synon të blejë të gjitha aksionet e zakonshme të emetuara dhe të papaguara pa vlerë nominale të Addiko Bank AG (ISIN AT000ADDIKO0).

Palët në transaksion:

Nova Ljubljanska Banka d.d., një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovenisë, me seli në adresën Trg. Republike 2, 1000 Ljublanë, Slloveni e regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me numër 5860571000. NLB d.d., është një nga institucionet financiare bankare më të rëndësishme dhe më të mëdha në Slloveni dhe në rajon, që ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe produktesh në lidhje me bankat, financat, menaxhimin e fondeve dhe pensionet, etj. (blerësi)

Në tregun e Kosovës, NLB d.d., është e pranishme përmes degës së saj: **NLB Banka SH.A.**, një shoqëri aksionare, e themeluar në përputhje me ligjet e Kosovës, me seli të regjistruar në Rr. "Ukshin Hoti", nr. 124, e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë ("ARBK") me numrin unik të identifikimit 810486250, e cila operon si bankë komerciale në përputhje me licencën e lëshuar nga BQK.

Addiko Bank AG, është një shoqëri aksionare, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Austrisë, me seli të në "Canetti Tower, Canettistraße" 5/OG 12, 1100 Vjenë, Austri, e regjistruar në regjistrin e kompanive të Gjykatës Tregtare (Handelsgericht) në Vjenë nën FN 350921 k. **Addiko AG**, është një grup bankar i specializuar, që operon në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve bankare për konsumatorët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Evropën Qendrore dhe Juglindore. Grupi Addiko përfshin, bankën amë austriake të licencuar dhe të regjistruar në Vjenë, Austri, e listuar në Bursën e Vjenës dhe e mbikëqyruar nga Autoriteti i Tregut Financiar Austriak dhe nga Banka Qendrore Europiane, si dhe gjashtë banka filiale, të regjistruara, të licencuara dhe të operuara në pesë vende të EQJL: Kroaci, Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë (ku operon përmes dy bankave), Serbia dhe Mal të Zi.

Struktura e Përqendrimit:

Transaksioni i propozuar është i bazuar në Ofertë Publike vullnetare të bërë nga pala njoftuese (NLB d.d.) mbi aksionet e Addiko Bank AG. Oferta në fjalë është ofertë publike dhe nënshtrohet legjislacionit Austriak, nëse transaksioni përfundohet, do të jetë në formën e marrjes së kontrollit, që synon të blejë të gjitha aksionet e zakonshme të emetuara dhe të papaguara pa vlerë nominale të Addiko Bank AG.

Tregu Relevant;

Tregu i produktit: Tregu i shërbimeve bankare - financiare, kredi për konsumatorë etj.

Tregu gjeografik: Elementi gjeografik i tregut, mund të përcaktohet si ndërkombëtar duke përfshirë edhe territorin e Republikës së Kosovës.

Analiza e konkurrencës:

Pas analizave të tregut lidhur me sektorin bankar. Në Kosovë operojnë gjithsej dymbëdhjetë banka komerciale. Produktet dhe shërbimet e tyre përfshijnë llogaritë bankare, kreditë, pagesa vendore dhe ndërkombëtare, kartela bankare, garancione bankare, letër kredi dhe e-banking etj. Duke parë që asnjë nga bankat në Kosovë nuk ka pozitë të ndjeshme në treg. Për më tepër, sipas indeksi Herfindahl–Hirschman (HHI) i industrisë bankare në Kosovë është 1,525 për asetet, 1,518 për depozitat dhe 1,535 për kreditë, ky treg klasifikohet si treg i përqendruara mesatarisht. NLB Banka Sh.A., ka një strukturë tregu përafërsisht nga 17-20%, mirëpo, duke parë që targeti nuk ka shtrirje të aktiviteteve në Kosovë dhe as nuk planifikon të ketë as të ardhmen pasi që aktivitetin e saj do ta shtrijë në vendet ku tashme është prezent. Blerësi synon që pas realizimit të transaksionit përmes targeti hyrën në sektorin bankar në tregun e Kroacisë në mënyrë indirekte, ndërsa sa i përket tregut të Republikës së Kosovës blerësi do të ruaj pozicionin aktual të tregut, që do të thotë se kushtet e konkurrencës do të mbesin të njëjta si para transaksionit. Transaksioni i propozuar nuk do të ndikoj në tregun e Republikës së Kosovës dhe si i tillë nuk ngrit shqetësimin për konkurrencën dhe as konsumatorët në Republikën e Kosovës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njohim të përqendrimit është bërë për arsye se Pala Njoftuese në transaksion e propozuar është prezentë në Kosovë përmes filialit të saj NLB Banka SH.A., një shoqëri aksionare, e themeluar në përputhje me ligjet e Kosovës. Duke marrë parasysh që targeti nuk ka prezencë, degë të regjistruar, zyrë përfaqësuese, kompani filiale, apo transaksione aktive/të kaluara në tregun e Kosovës, transaksioni i synuar nuk do të ndikojë në tregun e Kosovës. Transaksioni pritet të ndikojë vetëm në tregjet e Sllovenisë, Kroacisë, Serbisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Austrisë, sipas kushteve dhe kufizimeve të marrëveshjes ndërmjet palëve, Përvetësimi i shumicës së aksioneve në Target do t'i mundësonte NLB d.d. të arrijë një shkallë më të madhe në katër vende ku është tashmë e pranishme: Slloveni, Serbi, Bosnje-Hercegovinë dhe Mal të Zi, duke përforcuar kështu pozicionin e saj rajonal. Për më tepër, Addiko AG do t'i ofronte NLB d.d., mundësinë për të hyrë në sektorin bankar kroat në mënyrë indirekte. Kroacia është ekonomia më e madhe në rajonin e origjinës së Notifier dhe e vetmja ku aktualisht i mungon një operacion bankar. Sektori bankar kroat është tërheqës për shkak të madhësisë së tij të tregut dhe potencialit të rritjes, së bashku me sinergjitë nga shërbimi ndaj klientëve ekzistues të korporatave aktive në vend. Ndërsa Pala Njoftuese do të vazhdoj ta mbajë strukturën aktuale që ka në

tregun e Republikës së Kosovë, pra transaksioni nuk do të rezultojë në asnjë ndryshim në strukturën e tregut relevant në Kosovë, andaj transaksioni i propozuar nuk do të çojë në parandalim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në Kosovë, në veçanti nuk do të çojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese dhe si i tillë është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga "Njoftimi" nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva